



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosovo • Republic of Kosovo

Institucion i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 1872121

Nr.i fai/Br.str./Ni.pg.
01112121

Date/Datum/Date: 01/12/21

PRISHTINË PRISTINA PRISTINA



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS PËR VIZITËN NË QENDRËN E PARABURGIMIT NË PRISHTINË

Për: Znj. Albulena Haxhiu, ministër
Ministria e Drejtësisë

Kopje: Znj. Duda Balje, kryetare
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Petitione

Z. Habit Hajredinaj, drejtor
Zyra e Kryeministrat - Zyra për Qeverisje të Mirë

Z. Ali Gashi, ushtrues detyre i drejtorit të përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Z. Milazim Gjocaj, drejtor
Departamenti për Shëndetësinë në Burgje

Z. Sami Gashi, drejtor
Qendra e Paraburgimit në Prishtinë

Prishtinë, më 1 dhjetor 2021

HYRJE

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (tani e tutje: MKPT) i Avokatit të Popullit, më 5 tetor 2021 e vizitoi Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë (më tej: QPP).

MKPT-ja, bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, si dhe institucionet psikiatrike dhe të ato të kujdesit social.

Në QPP, përvèç të paraburgosurve, vendosen edhe një numër i vogël i të dënuarve. Kapaciteti zyrtar i kësaj qendre është për 300 persona. Gjatë vizitës që realizoi MKPT-ja në QPP, ishin të vendosur 190 të paraburgosur dhe 52 të dënuar.

Qëllimi i vizitës

1. Qëllimi i vizitës ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të burgosurve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe me standartet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve.

Bashkëpunimi i QPP-së me MKPT-në gjatë vizitës

2. Gjatë vizitës që realizoi MKPT-ja në QPP, personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës (në vijim: ShKK) dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (në vijim: DShB) i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje të papenguar në të gjitha vendet e vizituara dhe iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën, si dhe iu mundësuan intervistat me të burgosurit, pa praninë e zyrtarëve korrektues dhe të personelit shëndetësor.

Informimi për të drejtat e të burgosurve

3. Udhëzimi Administrativ MD-Nr. 07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese (më tej: Rendi Shtëpiak) përcakton obligimet e institucioneve korrektuese që, menjëherë pas pranimit, të sigurojnë kushte që i burgosuri të informohet me shkrim për të drejtat dhe detyrimet e tij.
4. Më tej Rendi Shtëpiak përcakton se Rendi Shtëpiak dhe Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (më tej: LESP) janë në dispozicion të të burgosurve gjatë gjithë kohës. I burgosuri i cili nuk di shkrim dhe lexim, informohet gojarisht për të drejtat dhe obligimet.¹ Megjithatë, MKPT-ja gjatë vizitës vërejti se i vetmi dokument në qelitë e të burgosurve ishte një dokument i cili përcakton rutinën ditore.

Keqtrajtimi fizik

5. MKPT-ja gjatë vizitës në QPP intervistoi një numër të konsiderueshëm të burgosurish dhe nuk mori asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës fizike të ushtruar nga zyrtarët korrektues apo për sjellje të autoriteteteve të burgut, të cilat do të përbënë shkelje të dinjitetit të të burgosurve. Përvèç kësaj, MKPT-ja vërejti se ekziston një klimë pozitive e marrëdhënieve dhe komunikim i mirë interaktiv ndërmjet të

¹ Udhëzimi Administrativ MD-Nr. 07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, nen 20.

burgosurve dhe zyrtarëve korrektues, si dhe ndërmjet personelit shëndetësor dhe të burgosurve.

6. Po ashtu, MKPT-ja gjatë vizitës në QPP nuk mori ankesa nga të burgosurit sa u përket trajtimit dhe respektimit të të drejtave të tyre themelore nga Policia e Kosovës.

Kushtet e akomodimit

7. LESP-ja shprehimisht përcakton se i dënuari ka të drejtë për strehim, i cili u përgjigjet kushteve bashkëkohore higjenike dhe rrethanave vendore klimatike.² Më tej ligji përcakton: “*Lokalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra katrorë hapësirë për qeli të vetme dhe katër (4) metra katrorë për të dënuarit në qeli të përbashkëta, dhe sasi të mjaftueshme të dritës natyrore dhe artificiale për punë dhe lexim, ngrohje dhe ajrosje.*”³
8. MKPT-ja vërejti se qelitë ku akomodoher të burgosurit kanë dritë të mjaftueshme natyrore, hapësirë banimi, e cila shkon përfje standardit të përcaktuar me LESP dhe me standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (më tej: KPT).⁴ Gjatë vizitës, MKPT vërejti se ka qeli adekuate në dispozicion të të burgosurve me aftësi të kufizuara, megjithatë, në disa qeli mungojnë orënditë adekuate për t'i vendosur gjësendet.
9. Gjatë vizitës, MKPT-ja vërejti se janë kryer disa rinvime me qëllim të evitimit të dëmtimeve në pjesë të caktuara të QPP-së, pasi QPP-ja, edhe pse objekt i ri, u përball me probleme të shumta infrastrukturore menjëherë pas futjes në funksion.

Ushqimi

10. LESP-ja përcakton të drejtën e të burgosurve për ushqim të përshtatshëm, në tri shujta për çdo ditë, për ruajtjen e mirë të shëndetit dhe të fuqisë së tyre, të cilat duhet të janë të llojlojshme dhe ushqyese. Ushqimi që i jepet personit të dënuar duhet t'i përshtatet moshës dhe gjendjes së tij shëndetësore, natyrës së punës, stinës e kushteve klimatike dhe, aq sa është e mundur, kërkesave të tij fetare dhe kulturore.⁵
11. Më tej ligji përcakton se personi i dënuar, i cili kryen punë të rënda, personi i sëmurë, gruaja shtatzënë, ose ajo e cila ka lindur fëmijë, kanë të drejtë për ushqim të caktuar nga mjeku edhe për ushqim dietal.⁶ **MKPT-ja nuk mori ankesa nga të burgosurit sa u përket cilësisë dhe sasisë së ushqimit.** Po ashtu, ushqimi dietal është në dispozicion të të burgosurve, sipas rekomandimit të mjekut.

² Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 36, paragrafi 1.

³ Ligji nr. 05/L0-129, neni 3 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

⁴ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Hapësira e Banimit për një të Burgosur, shih: <https://rm.coe.int/16806cc449/>.

⁵ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39, paragrafi 1.

⁶ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39, paragrafi 2.

Regjimi

12. Në QPP janë të angazhuar në punë një numër shumë i vogël i të paraburgosurve, ndërsa numri i të dënuarve të angazhuar në punë është më i madh. Në rastin e të paraburgosurve, angazhimi i tyre në punë varet nga leja e gjykatës.
13. Të burgosurit kanë në dispozicion dy orë shëtitje gjatë ditës, siç parashihet me LESP.⁷ QPP-ja ka katër shëtitore dhe dy fusha sportive, të cilat nuk janë në përdorim. Të paraburgosurit shumicën e kohës, respektivisht 22 orë i kalojnë në qelitë e tyre në mungesë të angazhimeve në punë apo në aktivitete, siç janë sporti, edukimi, trajnimet etj.
14. MKPT-ja vëren se sa i përket angazhimit në punë të të paraburgosurve, neni 199, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Penale përcakton si në vijim: "*I paraburgosuri mund të kryejë punë të nevojshme për mbajtjen e rendit dhe pastërtisë në ambientin e tyre. Të paraburgosurit mund t'i lejohet të punojë në aktivitete që i përgjigjen aftësive fizike dhe mendore brenda mundësive dhe kushteve me të cilat disponon institucioni dhe me kusht që të mos e dëmtojë procedurën penale. Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos për këtë në marrëveshje me drejtorinë e institucionit.*"
15. Ndërsa neni 200, paragrafi 1, i LESP-së, lidhur me angazhimin e të paraburgosurit në punë, përcakton si në vijim: "*I paraburgosuri mund të angazhohet me punë në punëtori, punëtoritë e njësive ekonomike të cilat gjenden në rrethin e institucionit korrektaus përkatës pas marrjes së pëlgimit të gjykatës kompetente.*"
16. MKPT-ja konsideron se bazuar në legjislacionin në fuqi, në Rregullat e Mandelës dhe në rekomandimet e KPT-së,⁸ autoritetet kompetente duhet të bëjnë përpjekje që të rriten angazhimet jashtë qelisë për të paraburgosurit, jo vetëm në QPP, por edhe në qendrat e tjera të paraburgimit, për aq sa një gjë e tillë është e mundur.

Incidentet ndërmjet të burgosurve

17. Autoritetet e burgut kanë obligime pozitive për ta parandaluar dhunën ndërmjet të burgosurve, për të cilët ata janë përgjegjës. Bazuar në dokumentacionin relevant, pohimet e drejtorisë dhe të të burgosurve, gjatë këtij viti në QPP nuk janë regjistruar incidente serioze ndërmjet të burgosurve.

Kujdesi shëndetësor

18. Neni 43 i Ligjit nr. 05/l-129 për Ndryshimin e Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton se i dënuari do t'i gëzojë të njëjtat standarde të kujdesit shëndetësor, të cilat janë në dispozicion në komunitet. LESP-ja më tej përcakton se këto shërbime mjekësore të burgosurve u ofrohen pa pagesë. Njësia shëndetësore në QPP përbëhet prej dy mjekëve të rregullt, të cilët punojnë me orar të plotë, dhe shtatë infermierë.
19. Ndërsa stomatologu dhe psikiatri janë në dispozicion një herë në javë. Psikologu është i angazhuar me orar të rregullt 8 orë në ditë. Po ashtu, në dispozicion të të burgosurve është

⁷ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 37.

⁸ Raporti i KPT-së për vizitën në Kosovë, publikuar në shtator 2016, paragrafi 46. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>.

edhe programi me metadon. Në laboratorin e njësisë shëndetësore është laboratori në të cilin mund të bëhen analiza biokimike dhe hemogrami.

20. Shërbimet e tjera specialistike kryhen në institucionet shëndetësore: në spitalet rajonale dhe në ato të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). MKPT-ja nuk mori asnjë ankesë nga të burgosurit sa u përket shërbimeve mjekësore që u ofrohen në QPP.
21. Gjatë vizitës, MKPT-ja hasi në një rast ku, pavarësisht rekomandimit të mjekut, i burgosuri ende nuk ishte dërguar në institucionin kompetent shëndetësor. Lidhur me këtë rast, në prani të MKPT-së, drejtori reagoi menjëherë në pajtim me rekomandimin e mjekut të njësisë shëndetësore të QPP-së.
22. Bazuar në të dhënrat e njësisë shëndetësore, gjatë vitit 2021, regjistruan 22 vetëlendime, 4 tentim vetëvrasje, 1 rast i vdekjes.
23. Në përgjithësi, të burgosurit u shprehën në favor të një trajtimi shumë të mirë nga personeli mjekësor, si në aspektin e shërbimeve të ofruara mjekësore, ashtu edhe në aspektin e komunikimit interaktiv dhe respektimit të dinjitetit të tyre njerëzor.

Prezenca e të burgosurve me sëmundje mendore

24. Prezenca e të burgosurve me sëmundje mendore vazhdon të jetë sfidë për qendrat e paraburgimit dhe për ato korrektuese, për shkak të mungesës së kapaciteteve për t'i akomoduar të burgosurit e kësaj kategorie në institucionin përkatëse shëndetësore. MKPT-ja gjatë vizitës në QPP u njoftua se për shkak të kapaciteteve të limituara në Institutin e Psikiatrisë Forenzike, në QPP ka të burgosur, të cilët, për shkak të gjendjes shëndetësore, nuk e kanë vendin në QPP.
25. Në këtë drejtim, MKPT-ja vëren se neni 43 i Ligjit nr. 05/l-129 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: "*Personi i dënuar të cilit nuk mund t'i ofrohet trajtim i duhur mjekësor në institucionin korrektues dërgohet në spitalin e institucionit korrektues, në institucionin psikiatrik adekuat, ose në ndonjë institucion tjetër për përkujdesje shëndetësore.*"
26. MKPT-ja me keqardhje vëren se më 19 gusht 2021, në QPP një i burgosur me probleme të shëndetit mendor kreu vetëvrasje. Më 3 korrik 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë vendosi që të burgosurit (tani të ndjerit) t'i caktohej masa e paraburgimit dhe që paraburgimi të mbahej në Institutin e Psikiatrisë Forenzike (më tej: IPFK). Për shkak të mungesës së vendeve të lira në IPFK, i burgosuri u akomodua në QPP, ku iu bë vlerësimi psikologjik dhe iu dha terapia psikiatrike sipas rekomandimit.
27. MKPT-ja konsideron se çdo vdekje e të burgosurve duhet të jetë subjekt i hetimit të hollësishëm nga autoritetet për të konstatuar, ndër të tjera, shkakun e vdekjes, përfshirë faktorët kontribuues, si dhe nëse vdekja ka mundur të evitohej. MKPT-ja mirëpret faktin që gjatë vizitës në QPP pas lajmit për vdekjen e të burgosurit, ka vërejtur se të gjitha autoritetet kompetente menjëherë filluan hetimet bazuar në mandatin që kanë. **Po ashtu, MKPT-ja përmes këtij reporti kërkon që autoritetet kompetente, të cilat hetuan këtë rast, t'ia dërgojnë reportin e hetimit.**

28. MKPT-ja, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, organizuan tryesa të rrumbullakëta dhe konferenca ku së bashku me autoritetet u diskutuan sfidat e trajtimit të të burgosurve me probleme të shëndetit mendor, si dhe sfidat rreth trajtimit të pavullnetshëm.
29. Gjatë këtyre takimeve, të pranishmit u pajtuan se autoritetet kompetente duhet të ndërmarrin veprime adekuate për t'i trajtuar të burgosurit e kësaj kategorie në pajtim me legjislacionin vendor dhe me standardet ndërkombe të drejtat themelore të të burgosurve. Ministritë kompetente, gjatë këtyre takimeve, prezantuan edhe planet e tyre për të gjetur zgjidhje adekuate për këtë kategori të burgosurish.
30. **MKPT-ja konsideron se autoritetet kompetente duhet të bëjnë përpjekje të vazhdueshme që këta persona të mbahen në institucione përkatëse, qoftë në ndonjë njësi të veçantë psikiatrike brenda burgut, në ndonjë spital apo në ndonjë institucion psikiatrik civil.**

Rëndësia e kontrolleve mjekësore për të burgosurit e sapopranuar

31. LESP-ja⁹ dhe Praktika Standarde e Veprimeve¹⁰ e DShB-së përcaktojnë obligimin e autoriteteve kompetente që i burgosuri i sapopranuar t'i nënshtrohet kontrollit mjekësor brenda 24 orëve nga momenti i pranimit.
32. Obligime të tilla përcaktohen edhe me aktet ndërkombe të drejtave të të burgosurve, siç janë: Rregullat e Mandelës¹¹, Rregullat Evropiane të Burgjeve¹² dhe standardet e KPT.¹³
33. Bazuar në pohimet e të burgosurve dhe në dokumentacionin relevant, të sapopranuarit, brenda 24 orëve i nënshtrohen kontrolleve mjekësore, në pajtim me LESP-në dhe me Praktikën Standarde të Veprimi të DShB-së.

Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore

34. Sa i përket konfencialitetit të shërbimeve mjekësore, MKPT-ja, bazuar në intervistat e zhvilluara me të burgosurit dhe me personelin shëndetësor, konstaton se këto shërbime jepen nën kushte të cilat respektojnë konfidencialitetin, respektivisht jepen pa prezencë të zyrtarëve korrektues, përveç në raste kur prezenca e tyre kërkohet nga mjeku. Ndërsa në dosjen mjekësore të të burgosurit ka qasje vetëm personeli shëndetësor.
35. Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore parashihet me Praktikën Standarde të Veprimit,¹⁴ e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë; me LESP-në¹⁵; me standardet e

⁹ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 31.

¹⁰ Praktika Standarde e Veprimeve, pika 1. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>

¹¹ Rregullat e Mandelës, Rregulli 34. Shih në: https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf

¹² Këshilli i Evropës, Rekomandimi (2006) 2 i Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve, pika 42.1. Shih në:

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804c221d/>

¹³ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti për vizitën në Suedi, 2015, paragrafi 81. Shih në: [https://hudoc.cpt.coe.int/eng#%22sort%22:\[%22CPTDocumentDate%20Descending,CPTDocumentID%20Ascending,CPTSectionNumber%20Ascending%22\],%22CPTSectionID%22:\[%22p-swe-20150518-en-25%22\]}](https://hudoc.cpt.coe.int/eng#%22sort%22:[%22CPTDocumentDate%20Descending,CPTDocumentID%20Ascending,CPTSectionNumber%20Ascending%22],%22CPTSectionID%22:[%22p-swe-20150518-en-25%22]})

¹⁴ Praktika Standarde e Veprimit, pika 11. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>

¹⁵ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 49.

KPT-së,¹⁶ si dhe me aktet ndërkombe të tjerë, siç janë: Rregullat e Mandelës¹⁷ dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.¹⁸

Masat disiplinore

36. Sipas legjislacionit në fuqi, dënimet disiplinore që mund t'u shqiptohen të dënuarve janë: qortimi, heqja e beneficionit të caktuar, urdhri për kompensim dhe vëtmia.¹⁹ Kurse në rastin e të paraburgosurve, mund të shqiptohen dënimet si në vijim: kufizimi apo ndalimi i vizitave apo i korrespondecës, përvèç kontakteve me avokatin mbrojtës, me Avokatin e Popullit dhe me misionet diplomatike.
37. Gjatë vizitës, MKPT-ja, bazuar në dokumentacionin relevant mjekësor, vërejti se masa disiplinore e vëtmisë u shqiptua në 7 raste. MKPT-ja nuk mori ankesa nga të burgosurit lidhur me respektimin e të drejtave të tyre gjatë qëndrimit në vetmi.

Kontakti me botën e jashtme

38. MKPT-ja konsideron se kontaktet me botën e jashtme, veçanërisht vizitat nga familja apo nga të afërmit e tjerë, janë të rëndësishëm thalbësore në kontekstin e rehabilitimit social të të burgosurve.
39. Legjislacioni në fuqi,²⁰ përfundet e personave të dënuar, përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar për korrespondecës (që u nënshtron përjashtimeve të caktuara), kanë të drejtë përfundit të vizitës në muaj, e cila zgjat më së paku një orë, si dhe kanë të drejtë përfundit të vizitës nga fëmijët dhe bashkëshortet e tyre, së paku një herë në 3 muaj, me kohëzgjatje minimale prej tri orësh. Sipas drejtorit të QPP-së, të paraburgosurit mund ta kenë një vizitë në dy javë, ndërsa të dënuarit mund t'i kenë katër vizita në muaj, të cilat zgjasin nga një orë.
40. Sa u përket thirrjeve telefonike, nen 60 i LESP-së përcakton se i dënuari ka të drejtë të bëjë thirrje telefonike. Në rastet e të paraburgosurve, këto telefonata autorizohen nga gjykata kompetente. Bazuar në informatat e siguruara nga drejtori i QPP-së dhe nga pohimet e të paraburgosurve, atyre u lejohet nga një telefonatë në javë, e cila është subjekt i lejes së gjykatës kompetente. Ndërsa në rastet e të dënuarve nuk ka kufizime.
41. Për shkak të pandemisë COVID-19, kontaktet me botën e jashtme u ndaluan dhe kohë pas kohe u reduktua numri i vizitorëve. Gjatë këtyre ndalesave, drejtoria e QPP-së u ofroi të burgosurve më shumë telefonata dhe komunikim përmes SKYPE.
42. MKPT-ja vizitoi edhe sallën e vizitave familjare, e cila ofron kushte të kënaqshme përfundit të pranuar vizita familjare. Salla e vizitave familjare përfundit të dënuarit ofron mundësinë e kontaktit të drejtpërdrejtë mes të dënuarit dhe personave të cilët e vizitojnë. Ndërsa në rastet e të paraburgosurve, situata është ndryshe, ndërmjet të paraburgosurit dhe vizitorëve ka bariera të cilat e pamundësojnë kontaktin e drejtpërdrejtë.

¹⁶ Standardet e KPT-së, publikuar në vitin 2018, paragrafët 50 dhe 51. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806ce943/>.

¹⁷ Rregullat e Mandelës, Rregulli 26, pika 2, në: https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf.

¹⁸ Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika A, Rregulli 19, në: https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf.

¹⁹ Paragrafët nga 101 deri në 113 të Ligjit nr. 04/L-149 përfundit Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

²⁰ Ligji nr. 04/L-149 përfundit Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 62-65.

43. MKPT-ja mori ankesa nga të burgosurit të cilët pohuan se për shkak të barrierave nuk mund të kenë kontakt fizik me familjarët e tyre, sidomos me fëmijët e tyre, të cilët nuk janë në gjendje t'i kuptojnë rrethanat e tillë. Kjo çështje është ngritur nga MKPT-ja edhe nëpërmjet Raportit me rekomandime për vizitën në QPP në vitin 2019.²¹
44. Në këtë drejtim, MKPT-ja vëren se KPT-ja, në raportin për vizitën në Ukrainë²², trajton çështjen e vizitave të mbyllura, të cilat bëjnë ndarjen fizike nëpërmjet xhamit pleksi, ndërmjet të burgosurit dhe personave të cilët e vizitojnë. Me këtë rast, KPT-ja u rekomandoi autoritetet e ukrainase që rregulloret relevante të ndryshohen ashtu që të gjithë të burgosurve, përfshirë edhe ata të paraburgosur, t'u mundësohet të pranojnë vizita në kushte të arsyeshme dhe të hapura, ndërsa përdorimi i objekteve të mbyllura për vizita do të duhej të ishte më shumë përjashtim sesa rregull.
45. Më tej KPT-ja theksoi se vizitat e tipit të mbyllur duhet të jenë gjithmonë të bazuara dhe të arsyetuara mirë, si dhe të bazuara në vlerësimin individual të rrezikut potencial, të cilin e paraqet i burgosuri i caktuar.
46. Prandaj, MKPT-ja inkurajon autoritetet kompetente që në fryshtë e këtij rekomandimi t'i shqyrtojnë mundësitë që këto vizita të zhvillohen në kushte më të hapura dhe duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut individual që përbën i burgosuri i caktuar.

Procedura e parashtrimit të ankesave

47. Neni 91 i LESP-së përcakton hollësishët procedurën sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t'i drejtohen me ankesë apo me lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK). Procedura përfshin edhe afatet për përgjigje nga drejtori dhe mundësinë që ankesa t'i drejtohet një autoriteti tjetër, që në rastin e tanishëm është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues dhe ministri i Drejtësisë.²³
48. MKPT-ja vërejti se në dispozicion të të burgosurve në QPP gjenden kutitë e ankesave, të vendosura nga ShKK-ja dhe ato të DShB-së. Po ashtu, ata mund t'i drejtojnë ankesë Avokatit të Popullit edhe nëpërmjet linjës telefonike pa pagesë, nëpërmjet postës së rregullt, e cila, sipas LESP-së, nuk i nënshtronhet kontrollit nëse i adresohet Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, si dhe nëpërmjet familjarëve të tyre.
49. MKPT-ja vërejti se të burgosurve në QPP u ofrohet mundësia qëkuante për parashtrim të ankesave dhe të kërkesave, drejtori i shqyrton ato dhe u dërgon përgjigje të burgosurve, në pajtim me LESP-në. MKPT-ja nuk mori ankesa nga të burgosurit sa i përket së drejtës për të parashtruar ankesë.

²¹ Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, publikuar më 22 nëntor 2019. Shih në: <https://www.oik-rks.org/wp-content/uploads/2019/11/Raport-me-rekomandimi-MKPT-s%C3%AB-lidhur-me-vizit%C3%ABn-n%C3%AB-Qendr%C3%ABn-e-Paraburgimit-n%C3%AB-Prishtin%C3%AB.pdf>

²² KPT, Raporti me rekomandime për vizitën në Ukrainë në dhjetor 2017, publikuar më 6 shtator 2018, paragrafi 102. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16808d2c2a>.

²³ Neni 91, paragrafi 4, i Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: “Në ankimin e paraqitur, drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jepet përgjigja në formën e shkruar.”

Personeli i QPP-së dhe çështje të ndërlidhura me sigurinë

50. Gjatë vizitës, MKPT-ja u njoftua se ka mungesë të dukshme të personelit korrektues dhe të zyrtarëve socialë, ndërsa numri i të burgosurve është shtuar dukshëm që kur në kuadër të QPP-së funksionon edhe njësia për vlerësimin e të burgosurve. MKPT-ja inkurajon autoritetet kompetente që të rrisin numrin e zyrtarëve korrekta dhe të personelit tjetër, duke pasur parasysh rritjen e numrit të të burgosurve të akomoduar në QPP.


Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve të MKPT-së gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17, paragrafi 7, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministrisë së Drejtësisë:

- Të njoftohen të burgosurit për të drejtat e tyre, në pajtim me LESP-në dhe me Rendin Shtëpiak.
- MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që të shtohen aktivitetet jashtë qelisë për të paraburgosurit në QPP, në pajtim me Kodin e Procedurës Penale dhe në pajtim me LESP-në, për aq sa një gjë e tillë është e mundur.
- Të furnizohen qelitë e të burgosurve me orendi të nevojshme për t'i vendosur gjësendet e tyre.
- Të rritet numri i personelit korrektues dhe i personelit tjetër sipas vlerësimit dhe nevojës, duke pasur parasysh rritjen e numrit të të burgosurve dhe të obligimeve në QPP.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj*”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), ju lutemi mirësish të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.


Me nederime,
Naim Qelaj
Avokat i Populli